

**SKEMA E VLERËSIMIT TË PROVIMIT PROFESIONAL NGA GJUHA
SHQIPE DHE LETËRSIA, GUSHT 2016**

1. Është rrethuar numri 2. *Për 30 deri në 60 ditë.* – **1 pikë**
2. Është rrethuar numri 2. *Mos të pihet duhani 2 orë.* - **1 pikë**
3. Është rrethuar numri 2. *Sasia përkatëse e tretësirës* – **1 pikë**
4. Nxënësi merr **2 pikë** nëse rrethon JO dhe përshkruan ose perifrazon fjalinë: *Niveli i punës së institucioneve të transfuzionit është i tillë që përgatitja e lartë dhe profesionale e kuadrit i garanton dhuruesit të gjakut një siguri maksimale. I tërë materiali për marrjen e gjakut është steril, apirogjen dhe për përdorim të njehershëm ose fjalinë: Çdo njësi e gjakut, që do të thotë gjaku i çdo dhuruesit, detyrimisht kontrollohet për: përkatësinë e grupit të gjakut, praninë e antitropave të jashtëzakonshëm (jo të rregullt), shkaktar të sëmundjeve që mund të transmetohen përmes gjakut (sëmundjet ngjitëse) sikurse janë shkaktarët e verdhëzës, AIDS-it (SIDËS) dhe sifilizit.*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar JO dhe ka shkruar saktë përgjigjen, por që ajo nuk ka stil.

Vërejtje: Pranohen edhe nëse nxënësi rrethon JO, por që është përgjigjur saktë sepse konsiderohet se i ka shpëtuar gabimi. Nëse ka rrethuar PO, nuk pranohet përgjigjja.

5. Gjithsej 3 pikë.

A) Është rrethuar numri 3- *Indriti* – **1 pikë**

B) Nxënësi merr **2 pikë** përse Marku, Joni dhe Sonila nuk mund të japin gjak, kurse Indriti mundet (p.sh. Marku nuk mundet sepse atë ditë duhet të drejtojë aeroplanin dhe personave që punojnë në lartësi u rekomandohet që atëherë mos të punojnë; Joni ka dhënë gjak para dy muaj e gjysmë, kurse distanca në mes të dy dhënieve të gjakut është nga 3 deri në 4 muaj; Sonila nuk mund të jap gjak sepse para gjashtë viteve ka qenë e sëmurë nga verdhëza, dhe ajo sëmundje e përjashton përherë dhuruesin nga dhënia e gjakut; Indriti mundet të jap gjak sepse e ka marrë një ditë të lirë sepse punon saldues në një firmë (dhe përgjigje tjera të sakta).

Nxënësi merr **1 pikë** nëse shpjegohet vetëm përse Indriti mund të jap gjak ose nëse shpjegon përse Indriti mund të jap gjak, kurse emrat e tjerëve vetëm i numëron.

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

6. *Me stilin shkencor – 1 pikë*

7. *më i rrezikshëm/më të mëdha – 1 pikë*

8. Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigjen e plotë të saktë:

parafjala – *për*

lidhëza – *edhe, e, i*

foljet ndihmëse – *janë, është*

9. **A)** *kallëzore – 1 pikë*

B) *e pashquar – 1 pikë*

10. Është rrethuar numri 2. *Gjithë pyetjeve për topografinë ata i përgjigjen me përpikëri dhe me zgjuarsi të madhe, ndërsa shpërblimi më i mirë për ta është leja për të parë goniometrin tim. – 1 pikë*

11. **A)** Nxënësi merr **1 pikë** për të gjitha presjet e vendosura saktë:

Çdo vijë e fytyrës, çdo lëvizje dorës, çdo fjalë, çdo hap i Skënderbeut tregonte njeriun e veprave të mëdha.

B) Nxënësi merr **2 pikë** nëse është përgjigjur: *Presja përdoret për të ndarë gjymtyrët homogjene (p.sh. kryefjalën, kallëzuesin, kundrinorin, përcaktorin etj. në një fjali të dhënë) që bashkohen pa lidhëza.*

Nxënësi merr **1 pikë** për një përgjigje më të thjeshtë, p.sh.: *për ndarjen e gjymtyrëve kryesore në fjalinë e dhënë*

12. **A)** Nxënësi merr – **1 pikë** për përgjigjen e plotë të saktë: *lidh.- lidhëz; euf. - eufemizëm; pj. - pjesëz*

B) Nxënësi merr – **1 pikë** për përgjigjen e plotë të saktë: *Bashkimi Evropian- BE; e të tjera - etj.; domethënë – d.m.th.*

13. Nxënësi merr – **1 pikë** për 4 ose 5 përgjigje të sakta: *katërshe, strofa, subjektiviteti, objektiviteti, këmba*

14. Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigjen e saktë: *përcaktorit*

15. Nxënësi merr – **1 pikë** për përshkrimin e 4 ose 5 formave të sakta të foljeve të kohës së tashme nga fjalia e dytë: *nderon, ardhka, të lahen, të ta thoja, vafsh e ardhsh.*

(Vërejtje: Nëse nxënësi me përgjigjet e sakta shkruan edhe përgjigjet e pasakta merr 0 pikë)

16. Nxënësi merr – **1 pikë** nëse ka përshkruar saktë pjesën e nënrenditur të fjalisë shkakore nga fjalia numër 3. *ngaqë përjashta ishte megjull*

17. Është rrethuar numri 2. *Trajtë e bashkuar* – **1 pikë**

18. **A) mburon** – **1 pikë**

B) fjala i përrallshëm i përket mbiemrit dhe është formuar me parashtesë dhe paranyjëzim njëkohësisht – **2 pikë**

Nxënësi merr **1 pikë** për caktimin e vetëm pjesës së ligjëratës të fjalës së dhënë ose vetëm tregon mënyrën e formimit të saj

19. *Ndjenjat e shpresës, guxim e shpresë* – **1 pikë**

20. *Tercina ose strofa treshe* – **1 pikë**

21. *Rima e veçantë me skemë: aba/bcb* – **1 pikë**.

22. Është rrethuar numri 3. *tre dhe nëntë* – **1 pikë**

23. Është rrethuar numri 2. *Melankolia dhe dhimbja botërore për pavetëdijen e botës dhe njeriut, kultivimi i ndjenjave të përkatësisë kombëtare.*
– **1 pikë**

24. Është rrethuar numri 3. *Malarme, Rembou, Verleni* – **1 pikë**

25. Nxënësi merr **3 pikë** për përgjigjen e plotë dhe të saktë:

Kroi i fshatit tonë – poezi, Lasgush poradeci

Hanko Halla - poemë, Ali Asllani

Tartufi – komedi, Moliere

Për çdo përgjigje të saktë - gjini letrare dhe emër e mbiemër të autorit të veprës së dhënë nga **1 pikë**

26. **A) Faik Konica, Doktor Gjilpëra** – **1 pikë**

B) rrëfimi, proze – **1 pikë**

27. **A) Doktor Gjilpëra** – **1 pikë**

B) Lufta e brendshme e intelektualit shqiptar për atdheun e vet – 1 pikë
28. Ëndrra e madhe për një Shqipëri të përparuar – 1 pikë

29. Nxënësi merr **2 pikë** jep përgjigjen e saktë: *Personazhi kryesor dëshiron t'u ngjaj Sokratit dhe Gëtes sepse ata jetuan dhe vepruan në vendin e vet.*
 Nxënësi merr **1 pikë** nëse tregon vetëm kujt dëshiron t'u ngjaj por nuk jep arsien që i çmon lartë këta njerëz.

30. Skema për vlerësimin e fletëparaqitjes

Përmbajtja	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura ndërtimore e tekstit
<p>- Nxënësi merr 1 pikë nëse i ka plotësuar saktë rubrikat To (azurna.obala@s p.edu.me.) dhe Subject (paraqitja për punë/punë sezonale/punë dhe përgjigje tjera të sakta)</p> <p>- Nxënësi merr 1 pikë nëse e ka plotësuar saktë paraqitjen, përkatësisht i ka shkruar të gjitha të dhënat e sakta që i kërkojnë (emrin dhe mbiemrin e kandidatit; ditën, muajin dhe vitin e lindjes; vendin e lindjes, komunën, shtetin; adresën e kandidatit; paraqitjen për</p>	<p>respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, kongruencës, përdorimi i gjuhës standarde</p> <p>2 pikë</p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë)</p> <p>2 pikë</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p> <hr/> <p>respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me</p>	<p>lidhshmëria e mirë në nivel të tekstit</p> <p>1 pikë</p>	<p>përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe strukturës ndërtimore të tekstit me strukturën logjike të tij</p> <p>1 pikë</p>

<p><i>punë në hotelin AZURNA OBALA në Perast dhe përgaditjen profesionale)</i> - Nxënësi merr 1 pikë nëse në rubrikën e <i>Vërejtjeve</i> i shkruan arsyet për të cilat duhet të pranohet në marrëdhënie të punës në kohë të caktuar. Për një përgjigje më të plotë merr 1 pikë.</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p>	<p>përdorimin semantik të parafjalëve për dhe mbi, përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave: që, i cili, e cila, të cilët etj.)</p> <p>1 pikë</p> <p>respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta (p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores ë)</p> <p>1 pikë</p> <p>Gjithsej 2 pikë</p>		
---	--	--	--